



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 1051 Prot.

Tiranë, më 24.6.2026

URDHËR

Nr. 81 Datë 24.6 2026

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME PËR SINJALIZIMIN, HETIMIN
ADMINISTRATIV DHE MBROJTJEN NGA HAKMARRJA TË SINJALIZUESIT NË
AGJENCINË E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE**

Në zbatim Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 96/2026 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”; VKM-së me nr. 150, datë 26.09.2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore” i ndryshuar; Urdhrit nr. 76, datë 24.06.2026 të Grupit të Menaxhimit Strategjik për miratimin e rregulloreve;

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregulloreve të brendshme “Për sinjalizimin, hetimin administrativ dhe mbrojtjen nga hakmarrja të sinjalizuesit në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore;
2. Zbatimin e rregulloreve të brendshme nga i gjithë stafi i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore;
3. Shfuqizimin e Urdhrit nr. 145, datë 30.11.2023 për miratimin e rregulloreve “Për sinjalizimin, hetimin administrativ dhe mbrojtjen nga hakmarrja të sinjalizuesit në agjencinë e menaxhimit të burimeve ujore”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
ANILA SHEHU**



**RREGULLORE E BRENDSHME PËR SINJALIZIMIN, HETIMIN
ADMINISTRATIV DHE MBROJTJEN NGA HAKMARRJA TË
SINJALIZUESIT
NË
AGJENCINË E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE**

Neni 1

Baza Ligjore

Rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimeve dhe për mbrojtjen e konfidencialitetit në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore bazohet në ligjin nr. 96/2025, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

Neni 2

Qëllimi

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për ndjekjen e procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimeve, si dhe i mekanizmave për mbrojtjen e konfidencialitetit, në përputhje me ligjin nr. 96/2025, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

Neni 3

Fusha e zbatimit

Çdo person që sinjalizon, raporton apo disponon informacion për veprime të kundërligjshme, apo shkelje të mundshme ligjore gjatë angazhimit të tij në një kontekst pune pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, përfshirë edhe persona që ofrojnë shërbime, apo bashkëpunojnë profesionalisht me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2025.

Neni 4

Përkufizime

Në funksion të objektit të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a. "Sinjalizim" është raportimi apo sinjalizimi i informacionit verbal, ose me shkrim nga sinjalizuesi te njësia përgjegjëse për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, të kryera në një mjedis pune të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, nëpërmjet kanaleve të brendshme, të jashtme, ose nëpërmjet publikimit, në përputhje me ligjin nr. 96/2025.

b. "Sinjalizim i brendshëm" është sinjalizimi i kryer nga sinjalizuesi brenda njësisë përgjegjëse të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore.

c. Sinjalizues" është çdo person fizik që në një kontekst pune sinjalizon, ose publikon informacione për shkelje të mundshme.

ç. "Njësia përgjegjëse" është struktura e posaçme e caktuar brenda Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, e cila funksionon si mekanizëm i brendshëm për sinjalizimin, e përbërë nga dy punonjës të ngarkuar me detyrën e ndjekjes së sinjalizimit dhe kryerjen e hetimit administrativ të tij, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 96/2025.

d. "Person i përfshirë" është çdo person fizik ose juridik, që përmendet në sinjalizim, ose publikim si personi të cilit i atribuohet shkelja ose që ka lidhje me autorin e shkeljes.

dh. "Informacion për shkeljet" është çdo lloj informacioni që përmban dyshime të arsyeshme dhe lidhet me shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, të kryera ose që ka gjasa të kryhen në të Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, të cilat janë përfutur në një kontekst pune.

e. "Kontekst pune" është çdo marrëdhënie profesionale, aktuale, e mëparshme ose e mundshme, përmes së cilës një person, pavarësisht nga natyra e saj juridike, ka akses në informacione për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, përfshirë marrëdhëniet e punësimit ose të vetëpunësimit, ofrimin e shërbimeve dhe marrëdhënie të tjera bashkëpunimi me të Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Neni 5

Parimet e shqyrtimit administrativ

Shqyrtimi dhe hetimi administrativ i sinjalizimeve kryhet në përputhje me këto parime:

- a. Ligjshmëria, duke respektuar dispozitat e ligjit nr. 96/2025 dhe legjislacionin në fuqi.
- b. Paanshmëria dhe objektiviteti, duke garantuar shqyrtim të pavarur nga çdo ndikim i jashtëm apo konflikt interesi.
- c. Konfidencialiteti, duke mbrojtur identitetin e sinjalizuesit dhe çdo informacion që mund të çojë në identifikimin e tij.
- ç. Mirëbesimi, duke vlerësuar sinjalizimin mbi bazën e bindjes së arsyeshme të sinjalizuesit për ekzistencën e një shkeljeje të mundshme.
- d. Proporcionaliteti, duke garantuar që çdo veprim administrativ të jetë i arsyeshëm dhe i nevojshëm në raport me qëllimin e hetimit.

Neni 6

Kanalet e sinjalizimit

1. Sinjalizimi i brendshëm/i jashtëm mund të bëhet:

- a. me shkrim, nëpërmjet depozitimit fizik në regjistrin e posaçëm;
- b. nëpërmjet adresës elektronike të dedikuar;
- c. në mënyrë verbale, përmes takimit fizik ose linjës telefonike të dedikuar;
- ç. në mënyrë anonime.

2. Sinjalizimi përmban:

- a. të dhënat e identitetit dhe të kontaktit të sinjalizuesit, përveç rasteve kur sinjalizimi bëhet në mënyrë anonime;
- b. organin ose personin e përfshirë ndaj të cilit raportohet shkelja;
- c. përshkrimin e informacionit për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, të shoqëruar me fakte, rrethana dhe dokumentacion mbështetës, për aq sa është e mundur;
- ç. referimin përkatës të legjislacionit të shkelur, për aq sa është e mundur.

3. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet nga Njësia Përgjegjëse si i tillë, vetëm nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht sinjalizimin/raportimin për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, të kryera ose që ka gjasa të kryhen në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

4. Identiteti i sinjalizuesit, në rastet kur identifikohet, mund të bëhet i njohur vetëm me pëlqimin e tij të shprehur, ose me kërkesë të organeve procedurale kompetente, në përputhje me ligjin.

5. Sinjalizimi verbal dokumentohet me procesverbal, i cili nënshkruhet nga sinjalizuesi, kur ky i fundit zgjedh të mos mbetet anonim.

6. Çdo sinjalizim regjistrohet në një regjistër të posaçëm, me akses të kufizuar, duke garantuar konfidencialitetin e identitetit të sinjalizuesit.

7. Sinjalizuesit i konfirmohet marrja e sinjalizimit brenda 7 ditëve nga regjistrimi, përveç rasteve kur ai ka kërkuar të mos njoftohet, ose kur njoftimi rrezikon konfidencialitetin.

8. Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së mësipërme sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigjojë të metat brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim.

Neni 7

Njësia Përgjegjëse

1. Administrimi dhe trajtimi i sinjalizimeve kryhet nga Njësia Përgjegjëse, e caktuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore.
2. Njësia Përgjegjëse përbëhet nga 2 anëtarë dhe ushtron funksionet e saj në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.
3. Njësia përgjegjëse ka këto detyra:
 - a. Merr, regjistron dhe administron sinjalizimet;
 - b. Siguron ruajtjen e konfidencialitetit të identitetit të sinjalizuesit dhe të informacionit të raportuar;
 - c. Kryen verifikimin paraprak dhe hetimin administrativ të sinjalizimeve, në përputhje me ligjin;
 - ç. Ndjek afatet procedurale të parashikuara nga ligji nr. 96/2025;
 - d. Dokumenton çdo veprim procedural me procesverbal;
 - e. Bashkëpunon me Inspektoratlin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, sipas rastit.
 - f. Përgatit dhe paraqet pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës, raportin vjetor të konsoliduar për sinjalizimet e marra dhe trajtimin e tyre, në përputhje me nenin 14, pika 12, të Ligjit nr. 96/2025.
4. Në rast konflikti interesi apo mungese të anëtarit, ai zëvendësohet sipas urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 8

Regjistri i sinjalizimi

1. Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posapëm protokolli ose elektronik për regjistrimin e sinjalizimeve.
2. Njësia përgjegjëse, nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizimit.

Neni 9

Shqyrtimi dhe hetimi administrativ i sinjalizimit

1. Njësia Përgjegjëse kryen verifikimin paraprak të sinjalizimit dhe nëse konstaton elementë që kërkojnë hetim të mëtejshëm, zhvillon hetimin administrativ brenda afateve të përcaktuara nga Ligji nr. 96/2025.
2. Procedura e hetimit administrativ përfundon sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e fillimit të saj, në përputhje me nenin 20 të Ligjit nr. 96/2025.
3. Gjatë hetimit administrativ, Njësia Përgjegjëse mund të kërkojë dokumente, informacione dhe sqarime nga strukturat përkatëse të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, duke garantuar konfidencialitetin e sinjalizuesit.
4. Çdo veprim procedural dokumentohet dhe përfundimi i hetimit pasqyrohet në raport të arsyetuar.

Neni 10

Mbrojtja e sinjalizuesit

1. Ndalohet çdo formë veprimi ose mosveprimi hakmarrës ndaj sinjalizuesit për shkak sinjalizimit të bërë në përputhje me ligjin nr. 96/2025.
2. Çdo akt hakmarrjeje është i pavlefshëm dhe nuk sjell pasoja juridike ndaj sinjalizuesit.
3. Çdo person që ndërmerr, ose tenton të ndërmarrë veprime hakmarrëse mban përgjegjësi disiplinore dhe, sipas rastit, përgjegjësi ligjore.
4. Mbrojtja nga hakmarrja zbatohet sipas mekanizmit dhe procedurave të parashikuara në ligjin nr. 96/2025.

Neni 11

Referimi tek autoritetet kompetente

1. Nëse gjatë shqyrtimit të sinjalizimit konstatohen elementë që bien në kompetencën e një autoriteti tjetër, Njësia Përgjegjëse referon çështjen pa vonesë pranë autoritetit përkatës, duke garantuar konfidencialitetin e identitetit të sinjalizuesit.
2. Në rast se sinjalizimi përmban elementë të përgjegjësisë disiplinore të një nëpunësi, çështja i referohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Në rast se sinjalizimi përmban indicie për kryerjen e një vepre penale, çështja i referohet organit kompetent të Agjencisë, sipas legjislacionit penal në fuqi.
4. Në rast se sinjalizuesi paraqet kërkesë për mbrojtje nga veprimet hakmarrëse, ose kërkon sinjalizim të jashtëm, ai informohet për të drejtën për t'u drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI).

Neni 12

Përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale të sinjalizuesit dhe të çdo personi tjetër të përfshirë në procesin e sinjalizimit përpunohen në përputhje me ligjin nr. 96/2025 dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Përpunimi i të dhënave kryhet vetëm për qëllimet e administrimit dhe shqyrtimit të sinjalizimit dhe kufizohet në masën e nevojshme për realizimin e këtyre qëllimeve.
3. Aksesimi në të dhënat personale u lejohet vetëm anëtarëve të Njesisë Përgjegjëse dhe personave të autorizuar sipas ligjit.
4. Të dhënat personale ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës dhe, në çdo rast, në përputhje me afatet e ruajtjes së dokumentacionit të parashikuara në këtë rregullore dhe në ligjin nr. 96/2025.
5. Zbulimi i paautorizuar i të dhënave personale përbën shkelje disiplinore dhe sjell përgjegjësi sipas ligjit.

Neni 13

Konfidencialiteti

1. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit, identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.
2. Njësia Përgjegjëse duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë, si dhe të mos e përdorë për

qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin e shprehur të sinjalizuesit, ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.

3. Njësia Përgjegjëse, në komunikimet me sinjalizuesin, apo çdo person të përfshirë në procesin e sinjalizimit, respekton detyrimin e konfidencialitetit dhe i komunikon informacionin e nevojshëm vetëm personave të caktuar për hetimin administrativ.

4. Punonjësit e Njesisë Përgjegjëse nënshkruajnë deklarata konfidencialiteti për moszbulimin/përhapjen e informacionit me të cilin ata njihen gjatë dhe pas ushtrimit të detyrës në këtë strukturë.

Neni 14

Ruajtja e dokumentacionit

1. Dokumentacioni i krijuar në kuadër të administrimit dhe hetimit administrativ të sinjalizimeve ruhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 96/2025 dhe legjislacionin për administrimin e dokumentacionit zyrtar.

2. Dokumentacioni origjinal ruhet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e komunikimit të rezultatit përfundimtar të procedurës së sinjalizimit, përveç rasteve kur procedura ligjore përkatëse është ende në proces dhe nuk ka përfunduar.

Neni 15

Raportimi në ILDKPKI

1. Njësia Përgjegjëse zbaton detyrat e ngarkuara nga ILDKPKI-ja për lehtësimin dhe zhvillimin e procesit të sinjalizimit, si dhe i paraqet ILDKPKI-së çdo vit, jo më vonë se data 15 Janar e vitit pasardhës, raport me shkrim për sinjalizimet e regjistruara, mënyrat e ndjekura për hetimin administrativ të sinjalizimeve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

2. Në këtë informacion përfshihen numri i rasteve të sinjalizuara, rezultatet e rasteve, shkalla e ndërgjegjësimit dhe besimit të mekanizmat e sinjalizimit nga publiku, koha e përcaktuar për shqyrtimin e rasteve, sipas formularëve bashkëlidhur dhe pjese e pandare e kësaj rregulloreje:

- Formulari për Sinjalizimin e brendshëm (*lidhja 1*);
- Formulari për Sinjalizimin e jashtëm (*lidhja 2*);
- Formulari për kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja (*lidhja 3*);
- Regjistri për sinjalizimin e brendshëm, (*lidhja 4*);
- Regjistri i kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit (*lidhja 5*).

Neni 16

Njohja dhe zbatimi i rregullores

1. Me këtë rregullore të njihen nëpunësit civil dhepunonjësit që trajtohen me Kodin e Punë në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

2. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

FORMULAR I SINJALIZIMIT TË BRENDSHËM
"TE NJË VEPRIM OSE PRAKTIKE TË DYSHUAR KORRUPSIONI"

DREJTUAR: Njësia Përgjegjëse të caktuar në zbatim të ligjit nr. 96/2025 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"

Unë sinjalizuesi _____, lindur më _____ vendlindja _____, banues në adresën: _____ dhe me kontakte _____ me detyrë _____ në _____.

paraqes sinjalizimin si më poshtë vijon:

Unë sinjalizuesi zgjedh të mbetem anonim duke shpjeguar qartë dhe nëmënyrë të arsyetuar shkaqet e anonimatit si më poshtë:

paraqes sinjalizimin si më poshtë vijon:

Bashkëlidhur këtij sinjalizimi, provat përkatëse që paraqes janë si më poshtë:

Nuk kam prova përkatëse, por ato mund të gjenden:

Përkëto arsye, kam dyshime për ekzistencën e një fakti që përben veprën penale të parashikuar nga neni _____ i Kodit Penal (nëse është e mundur ta përcaktoni një gjë të tillë.)

Ky formular sinjalizimi u mor në dorëzim më _____ nga _____ punonjës i Njësia Përgjegjëse në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Sinjalizuesi

(_____)

Njësia përgjegjëse

(_____)

FORMULAR I SINJALIZIMIT TË JASHTËM
“TË NJË VEPRIMI OSE PRAKTIKE TË DYSHUAR KORRUPSIONI”

DREJTUAR: Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në zbatim të ligjit nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve

2. Unë sinjalizuesi _____, lindur më _____, vendlindja _____, banues në adresën: _____ dhe me kontakte _____, me detyrën e _____ në _____, paraqes sinjalizimin si më poshtë vijon:

3. Unë sinjalizuesi zgjedh të mbetem anonim duke shpjeguar qartë dhe në mënyrë të arsyetuar shkaqet e anonimatit si më poshtë:

Paraqes këtë sinjalizim në ILDKPKI, për arsye se :

1- _____ nuk ka Njësi përgjegjëse në zbatim të ligjit nr. 96/2025.

dhe paraqes sinjalizimin si më poshtë:

2- Njësia përgjegjëse në _____ për sinjalizimin e paraqitur më datë _____ (bashkëlidhur formulari i sinjalizimit të bërë), pranë njësisë;

☐ nuk filloi hetimin administrativ ose e përfundoi atë në kundërshtim me ligjin nr. 96/2025.

☐ zoti/zonja _____ që pret sinjalizimin ose zoti/zonja _____ janë përfshirë ose kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë personal ose material me objektin e sinjalizimit sepse _____

☐ Dyshoj në integritetin dhe paanshmërinë e Njësisë përgjegjëse për shkak sepse _____

☐ Prova _____ e këtij sinjalizimi që gjendet në _____ fshihet apo shkatërohet nga _____

Bashkëlidhur këtij sinjalizimi, provat përkatëse që paraqes janë si më poshtë:

Nuk kam prova përkatëse, por ato mund të gjenden _____

Për këto arsye, kam dyshime për ekzistencën e një fakti që përbën veprën penale të parashikuar nga neni _____ i Kodit Penal (nëse është e mundur ta përcaktoni një gjë të tillë.)

Ky formular sinjalizimi u mor në dorëzim më / ____ / ____, në _____ nga _____, Inspektor në ILDKPKI.

Sinjalizuesi

Inspektor

Emër Mbiemër

Emër Mbiemër

FORMULAR KËRKESË PËR MBROJTJE NGA HAKMARRJA
(në zbatim të ligjit nr. 96/2025 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve")

1. Unë sinjalizuesi _____, lindur më _____ vendlindja _____, banues në adresën: _____
_____ dhe me kontakte _____ me detyrën _____
në _____ kam paraqitur sinjalizimin ne:

a. _____, pranë njësisë përgjegjëse

b. ILDKPKI
(bashkëlidhur formulari i sinjalizimit të bërë)

2. Për shkak të këtij sinjalizimi, pretendoj se jam subjekt i një akti hakmarrjeje të marrë ndaj meje si më poshtë:

Me _____ në
Organizatën _____

për shkak se ndaj meje është marrë masa _____
(bashkëlidhur nëse kenë akt për masën e dhënë ose tregoni kush e disponon)

Në këto kushte mbështetur në nenet 18 dhe 19 të ligjit nr. 96/2025 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"
paraqes kërkesën për mbrojtjen nga akti i hakmarrjes ndaj meje, pranë:

1. Njësisë përgjegjëse në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore

2. ILDKPKI, për shkak se;

a) Nuk ka Njësi përgjegjëse në _____

b) Njësia përgjegjëse nuk ka marrë masat brenda afatit ligjor 10 ditor, nga paraqitja e kërkesës për mbrojtje nga sinjalizuesi (bashkëlidhur kërkesa për mbrojtje e paraqitur tek njësia përgjegjëse).

1-Ky formular karkës për mbrojtje nga hakmarrja, u mor në dorëzim më / / nga, punonjësi i njësisë përgjegjëse.

Ky formular sinjalizimi u mor në dorëzim më _____ nga _____ punonjës i Njësisë
Përgjegjëse në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Sinjalizuesi
(_____)

Njësia përgjegjëse
(_____)

2-Ky formular kërkesa për mbrojtje nga hakmarrja u mor në dorëzim më _____ në, nga _____
Inspektor në ILDKPKI.

Sinjalizuesi
(_____)

Inspektori
(_____)

(Lidhja 4)

[illegible]

